

Titulli i lëndës: Letërsi botërore e shekullit XX

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Letërsi botërore e shekullit XX
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i katërt Semestri i shtatë
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 74 E hënë 10 – 11:30
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Osman Gashi
Të dhënat kontaktuese:	+383 44 174 174 // osman.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs përfshinë materien letrare nga fusha e letërsisë botërore përgjatë shekullit XX. Trajton vepra letrare, autorë e dukuri sipas rrjedhës historike dhe sipas zhvillimeve zhanrore (gjinitë, zhanret e llojet letrare), me theks të veçantë në analizën e veprave më përfaqësuese të të gjithë letërsisë.
Qëllimet e lëndës:	Gjatë ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësi: <ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në shekullin XX në vende të ndryshme e në faza të ndryshme të zhvillimit; - Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike e analitike; - Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko - letrare;
Rezultatet e pritshme të nxënies:	- Studentët do të arrijnë të marrin informacione dhe të njohin orientimet stilistike dhe konceptet si: Modernizmi, Avangarda, Simbolizmi, Futurizmi, Dadaizmi, Surrealizmi, Postmoderna etj. - Do të arrijnë të analizojnë strukturën e veprave përkatëse të periudhave të sipërpërmendura.
Metodat e mësimdhënies:	- Ligjërata, seminare, diskutime, punë në grupe, shkrime esesh... - Ligjërata, ushtrime gjatë orëve të mësimi, duke përdorur materiale të ndryshme, punë në grupe prej 2-3 studentësh në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale...

Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50 %. Vijueshmëria e studentit 10 %; Detyrat individuale të kryera në klasë 10 %; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10 %; Vlerësimi nga testet 20 %; Provimi final 50 %.
Veprat letrare:	Sharl Bodler: Lulet e së keqes ; Herman Hese: Ujku i stepës ose Sidharta ; Xhems Xhojs: Uliksi ose Portreti i artistit në rini ; Tomas Man: Budenbrokët ; Franc Kafka: Procesi, Metamorfoza ; Marsel Prust: Anës Suanit ; Mihail Bullgakov: Mjeshtri dhe Margarita ; Semjuel Beket: Duke pritur Godonë ; Federiko Garcia Lorka: Poezi ; Sergej Jesenin: Poezi ; Ernest Heminguej: Për kë bie kambana ; Dino Buxati: Shkretëtira e tatarëve ; Alber Kamy: I huaji ; Milan Kundera: Shakaja ; Gabriel Garcia Markes: 100 vjet vetmi ose, Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar ; Xhorxh Oruell: 1984 ose Ferma e kafshëve ; Umberto Eko: Emri i trëndafilut ; Horhe Luis Borhes: Fiksionet ose Aleph .
Literatura shkencore:	Linda Hutcheon: Poetika e postmodernizmit , OM, Prishtinë, 2013. Jorgji Doksani, Agim Doksani: Letërsia botërore e shekullit XX , Tiranë, Uegen, 2008. Agron Tufa: Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX , Tiranë 2008, shlb, Tiranë 2008. Osman Gashi: Letërsia dhe miti (studime krahasimtare), Prishtinë, 2008
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Tiparet themelore të letërsisë së shekullit XX; Bashkëkohësia dhe tradita (konceptet bazike);
Java 2:	Themelet e letërsisë bashkëkohore, shekulli XIX - Romantizmi, Realizmi; Pararendësit (Bodleri, Verlen, Mallarme, Rembo)
Java 3:	Letërsia e Qarkut kulturor evropian në shek XX, Periudhat dhe Drejtimet
Java 4:	Letërsia e Qarkut kulturor evropian në shek XX (II); - Zhvillimet zhanrore (Poezia, Romani, Drama)
Java 5:	Rrymat dhe shkollat letrare të shek. XX, (ekspresionizmi, futurizmi, dadaizmi,)
Java 6:	Rrymat dhe shkollat letrare të shek XX (II) (Surrealizmi, Realizmi magjik, Realizmi socialist)
Java 7:	Proza moderne e shek. XX

Java 8:	Franc Kafka, Xhems Xhojsi
Java 9:	Herman Hese, Tomas Man, Alber Kamy
Java 10:	Struktura e poezisë bashkëkohore (Eliot, Neruda...)
Java 11:	Drama e shekullit XX, Teatri i absurdit (Breht, Jonesko, Beket, Pirandello, Ibsen)
Java 12:	Modernizmi dhe Postmodernizmi (veçoritë, afritë, diferencat)
Java 13:	Zhvillimet letrare të fundshekullit XX dhe fillimet e shekullit XXI
Java 14:	Zhvillimet letrare të fundshekullit XX dhe fillimet e shekullit XXI (II)
Java 15:	Përmbyllje e kursit – rekapitulim i lëndës

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.